



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

Sintaksë e gjuhës B

Ngarkesa: 4 kredite (= 40 orë); 2 Kredite Leksion (= 20 orë); 2 Kredite seminar (= 20 orë)

Viti akademik / semestri kur zhvillohet: Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Gjuhë Angleze

Kodi i etikës: Kodi i Etikës i UT-së (Nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva te përgjithshme lëndore: Të pajisë studentët me njohuri të thelluara mbi strukturën gramatikore të gjuhës angleze, duke theksuar rolin e sintaksës në ndërtimin e fjalive dhe kuptimit të tyre. Të zhvillojë ndërgjegjësimin gjuhësor të studentëve, nëpërmjet analizës së lidhjes midis formës, kuptimit dhe funksionit në kontekst. Të ndihmojë studentët të kuptojnë gjuhën si një sistem të strukturuar, ku sintaksa ka një rol themelor në ndërtimin dhe interpretimin e ligjërimit. T'i përgatisë studentët për të bërë përgjithësime teorike, të domosdoshme për një specialist të gjuhës dhe për të përfituar kompetenca akademike në fushën e gjuhësisë. Të konsolidojë dhe zhvillojë më tej njohuritë gramatikore të përftuara, me fokus të veçantë në strukturat e fjalive dhe funksionin e tyre në tekst.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të njohë studentët me konceptet kryesore të sintaksës, si: fjalia, fjalia e thjeshtë, e përbërë, sintagmat emërore, foljore, mbiemërore, parafjalore, rendi i fjalëve, inversioni etj.
2. T'i ndërgjegjësojë studentët për shumëllojshmërinë e strukturave sintaksore që gjenden në gjuhën angleze.
3. Të zhvillojë aftësinë për të analizuar dhe përdorur saktë strukturat sintaksore, duke theksuar ngjashmëritë dhe ndryshimet mes tyre.
4. Të thellojë kuptimin e funksionit të fjalëve dhe sintagmave në fjali, duke kaluar përtej analizës së thjeshtë të formës.
5. T'u ofrojë studentëve një trajtim të qartë dhe praktik të çështjeve sintaksore problematike për përdoruesit jo-nativë të anglishtes.

Rezultatet e të nxënit: Në fund të semestrit studentët do të jenë të aftë

1. Të përkufizojnë dhe shpjegojnë konceptet bazë në analizën sintaksore (duke iu referuar veçanërisht strukturës së gjymtyrëve të fjalisë, strukturës së frazës, funksioneve gramatikore, llojeve të fjalisë);
2. Të zbatojnë njohuritë e tyre të morfosintaksës në analizimin e të dhënave;
3. Të krahasojnë anglishten e sotme standarde me gjuhë të tjera (duke iu referuar sidomos veçorive morfosintaksore);
4. Të demonstrojnë një qasje kritike ndaj zhvillimit të një gramatike përshkruese;